



Data: 22.02.2019

Ref.: 310/130

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 61-të, të mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019, mori:

## V E N D I M

I. Refuzohet kërkesa e Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" (Nr.1498/18H, datë 31.10.2018) për akreditim të programeve të studimit si më poshtë:

- Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Professional, 180 ECTS;
- Efiçenca, Energjia dhe Mjedisi, Bachelor Professional, 180 ECTS, dhe
- Inxhinieria e Aplikuar Kopmjuterike, Bachelor Professional, 180 ECTS.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetimi

Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli" (tash e tutje Kolegji Tempulli) ka parashtruar kërkesë (Nr.1498/18H, datë 31.10.2018) në Agjencinë e Kosovës për Akreditim për riakreditim dhe akreditim të programeve të studimit si në vijim: Inxhinieria e Transportit dhe Infrastruktura Rrugore, BSc, 180 ECTS; Inxhinieria e Trafikut dhe Siguria Rrugore, MSc, 120 ECTS; Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Professional, 180 ECTS; Efiçenca, Energjia dhe Mjedisi, Bachelor Professional, 180 ECTS, dhe Inxhinieria e Aplikuar Kopmjuterike, Bachelor Professional, 180 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018, (tash e tutje UA për Akreditim), KSHC në mbledhjen e mbajtur më 15 dhe 16 janar 2019 ka trajtuar aplikacionin e Kolegji Tempulli, dhe pas analizës së dokumentacionit të stafit akademik bazuar në pikën 1.2 të këtij neni, 10 të UA për Akreditim, thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KSHC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë*



elektronike se bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stafit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së”, KShC erdhi në përfundim se programet e studimit: Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Professional, 180 ECTS; Efienca, Energjia dhe Mjedisi, Bachelor Professional, 180 ECTS, dhe Inxhinieria e Aplikuar Kompjuterike, Bachelor Professional, 180 ECTS, nuk i plotësojnë kushtet ligjore për aprovim të aplikacionit.

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

1. Për programin e studimit: *Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Professional, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Tempulli ka paraparë këta persona: Visar Baxhuku (MA në Shkenca Teknike), Fatmir Musliu (MA në Transport dhe Telekomunikacion), Arsim Azemi (MA Komunikacion Rrugor dhe Transport), Fatbardh Xhaferi (MA në Menaxhment dhe Financa), Jakup Mehmeti (MA në Transport dhe Telekomunikacion).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *“Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.*

Këto programe i përkasin studimeve profesionale dhe trajtohen sipas nenit 27 të UA për Akreditim. Sipas nënpikës 5.1 të pikës 5 të nenit 27 të UA për Akreditim: *“Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, më përvojë relevante se paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente”.* Ndërsa sipas nënpikës 5.2 të nenit 27 të UA për Akreditim, *“Kërkesat minimale akademike për stafin mësimdhënës që i vlerëson studentët duhet të jetë përfundimi i studimeve master”.*

Bazuar mbi sqarimet e dhëna më sipër dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Tempulli, u konstatua që asnjëri nga bartësit nuk i përmbushë kriteret ligjore për të qenë bartës i këtij programi të studimit, pasi që asnjëri nga ata nuk e ka përvojën relevante prej pesë vitesh, ashtu siç kërkohet në nënpikën 5.1 të nenit 27.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Menaxhimi dhe Ekonomia e Transportit, Bachelor Professional, 180 ECTS*.



2. Për programin e studimit: *Efiçenca, Energjia dhe Mjedisi, Bachelor Professional, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Tempulli ka paraparë këta persona: Gjeloš Vataj (Ing në Mekanik), Drita Qerimi (MA në Shkenca Teknike), dhe Rrezarta Qitaku (MA në Shkenca Teknike).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018): *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Këto programe i përkasin studimeve profesionale dhe trajtohen sipas nenit 27 të UA për Akreditim. Sipas nënpikës 5.1 të nenit 27 të UA për Akreditim: *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, më përvojë relevante se paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente"*. Ndërsa sipas nënpikës 5.2 të nenit 27 të UA për Akreditim, *"Kërkesat minimale akademike për stafin mësimdhënës që i vlerëson studentët duhet të jetë përfundimi i studimeve master"*.

Bazuar mbi sqarimet e dhëna më sipër dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Tempulli, u konstatua që vetëm Gjeloš Vata ka përvojën relevante prej pesë vitesh ashtu siç përcaktohet në nenin 27, pika 5.1 e UA për Akreditim, ndërsa Drita Qerimi dhe Rrezarta Qitaku nuk i përmbushë kriteret ligjore për të qenë bartës, pasi që asnjëri nga ata nuk e ka përvojën relevante prej pesë vitesh.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Efiçenca, Energjia dhe Mjedisi, Bachelor Professional, 180 ECTS*.

3. Për programin e studimit: *Inxhinieria e Aplikuar Kopmjeterike, Bachelor Professional, 180 ECTS*, si bartës të këtij programi Kolegji Tempulli ka paraparë këta persona: Astrit Emini (MA në Inxhinieri Elektrike), Gentiane Xheladini (MA në Ekonomi), Granit Hajra (i mungon dokumentacioni), dhe Avni Beqiri (MA në Shkenca Teknike).

Sipas nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: *"Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statuti të IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*.

Këto programe i përkasin studimeve profesionale dhe trajtohen sipas nenit 27 të UA për Akreditim. Sipas nënpikës 5.1 dhe 5.2 të pikës 5 të nenit 27 të UA për Akreditim. Sipas nënpikës 5.1, *"Stafi për mësimdhënie duhet të jetë i kualifikuar në aspektin akademik dhe profesional, më përvojë relevante se paku 5 vjeçare në fushën përkatëse, i përzgjedhur në procedurë transparente"*. Ndërsa sipas nënpikës 5.2 të nenit 27, të UA për Akreditim, *"Kërkesat minimale akademike për stafin mësimdhënës që i vlerëson studentët duhet të jetë përfundimi i studimeve master"*.


Bazuar mbi sqarimet e dhëna më sipër dhe pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Tempulli, u konstatua që asnjëri nga bartësit nuk i përmbushë kriteret ligjore për të qenë bartës, pasi që asnjëri nga ata nuk e ka përvojën relevante prej pesë vitesh, ashtu siç kërkohet me nënpikën 5.1 të nenit 27.

Andaj bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara me lartë, KSHC erdhi në përfundim që ky program i studimit nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim, dhe mbi këtë bazë, vendosi ta refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit, *Inxhinieria e Aplikuar Kopmjuterike, Bachelor Professional, 180 ECTS*.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi u dërgohet:

- BPrAL Kolegji i Shkencave të Aplikuara Teknike "Tempulli";
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë